

Permbledhje joteknike e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

per zhvillimin e aktivitetit

“ Grumbullim skrapi dhe Demontim i mjeteve jashte perdorimit”



Vendodhja e aktivitetit: Fshati Gocaj, Balldren, Lezhe

Shoqeria : ROBI - IMPORT - SERVIS shpk

Administrator: Arben Robi

ROBI-IMPORT-SERVIS
NIPT:K98609501V
BALLDRE-LEZHE

Handwritten signature of Arben Robi in blue ink.

Lezhe 2022

PERMBAJTJA

- **Hyrje**
- **Informacion per qellimin e VNM dhe metodiken e zbatuar**
- **Pershkrimi i projektit**
- **Pershkrim i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi**
- **Informacion per pranine e burimeve ujore ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij**
- **Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme negative ne mjedis te projektit perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer**
- **Nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis te tilla si ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime si dhe per prodhimin e mbetjeve**
- **Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuara**
- **Te dhena per shtrirjen e mundshme hapesine te ndikimit negativ ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te**
- **Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme si dhe kostot financiare te peraferta per rehabilitimin**
- **Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis**
- **Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille)**

HYRJE

Raporti synon te jape nje informacion te detajuar dhe te besueshem lidhur me ndikimin mjedisor te projektit te propozuar ne perdorimin e tokes, efektet lidhur me ndikimet ne floren, faunen, burimet e ujit, emetimin e gazeve sere ne atmosfere, shkarkimet ne toke, uje, ndotjen akustike, si dhe çdo ndikim social ekonomik ne punesimin lokal, permiresimin e infrastruktures dhe ndikimeve te tjera te rendesishme mjedisore ose sociale, perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrueshmerise se mjedisit nepermjet :

- Marrjes ne konsiderate te çeshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se projektit.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit te aktivitetit
- Analizen e faktoreve pozitive e negative mjedisore, percaktimin e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimin cilesor te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt.

Per kete problem u be mbikqyrja e terrenit ne te gjithë zonen, duke kryer vrojtime te ndryshme , si dhe te biodiversitetit.

Qellimi i VNM- se

Qellimi i hartimit te raportit te VNM-se eshte percaktimi i efekteve negative dhe pozitive te aktivitetit dhe masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis si rezultat i zhvillimit te projektit.

VNM nuk do te mbuloj çdo aspekt te nje efekti mjedisor te projektit, me te njejtin nivel detajesh. Theksi do te vihet ne ndikimet kryesore qe shkakton zhvillimi i aktivitetit.

Gjithashtu nje synim tjetër eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative per zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zvillimit te aktivitetit dhe te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te aktiviteve te propozuara.

VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrueshmerise se mjedisit nepermjet :

- ✓ Marrjes ne konsiderate te ndikimeve te mjedisit qe ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.
- ✓ Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- ✓ Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit ne mjedis te aktivitetit
- ✓ Analizes se faktoreve pozitive e negative mjedisore dhe te masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
- ✓ Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimi cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- ✓ Propozime te masave zbutese te ndikimit ne mjedis te projektit.

PERSHKRIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

Qëllimi I aktivitetit

Qëllimi i këtij aktiviteti është demontimi I automjeteve te dal jashte perdorimit, magazinimi I skrapeve qe dalin nga ky process dhe që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme si dhe stacion transferimi per mbetjet jo te rrezikshme qe dalin nga demontimi I automjeteve.

Aktiviteti zhvillohet ne nje ambjent te pershtatshem per kete aktivitet duke mos krijuar keshtu deme apo efekte negative te ndryshme ne mjedisin perreth.

Vendodhja

Aktiviteti do te zhvillohet ne pasurine me nr. 349/33, zona kadastrale 1873, siperfaqe totale 3151 m2, siperfaqe ndertimi 1075 m2, ne pronesi te Petrit Zef Robi, Gocaj , Lezhe.

Kapanoni eshte objekt ekzistues ne te cilin shoqeria ka zhvilluar aktivitetin e magazinimit te pjeseve te kembimit me qellim tregtimin e tyre.

Prone e marr me kontrate huaperdorje nga shoqeria ROBI-IMPORT -SERVIS shpk.

Kordinatat e vendodhjes jane si meposhte:

Sistemi GAUSS KRUGER		
Nr.	E	N
1	4386989.98	4633988.82
2	4386991.49	4633968.15
3	4387001.83	4633953.67
4	4386929.82	4633903.05
5	4386915.83	4633934.02

Sistemi KRRGJSH		
Nr.	E	N
1	469929.05	4633023.53
2	469930.8	4633002.88
3	469941.3	4632988.53
4	469869.9	4632937.08
5	469855.55	4632967.88

4306630 120
4634035 276


4387061 663
4634032 233



4306628 104
4633668 944

4387069 726
4633665 899

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse. Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.



Sistemi koordinativ: Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4
Projektimi: KRGJSH

- Legjenda**
- Emërtime Gjeografike (ASIG)
 - Zonat Kadastrale
 - Shtresë Bazë
 - Panorizat
 - Ndërtesat
 - Rendi 4 (Kufi njësor administrativ)
 - Rendi 3 (Kufi Bashki)
 - Rendi 2 (Kufi Qarku)

Procesi I demontimit te automjeteve

Ambienti per cmontimin e mbetjeve nga motoret e makinave eshte vendi ku kryehen proceset per cmontimin e pjeseve te makinave te dala jashte perdorimit, me qellim riperdorimin e tyre dhe grumbullimin e skrapit. Pjeset cmontohen me ndihme e pajisjeve te servisit dhe i nenshtrohen procesit te kontrollit fizik te tyre, duke pare gjendjen funksionale. Gjithashtu ne kete ambjent bejne pjese edhe hapësirat per levizjen e mjeteve, njerezve dhe siperfaqet e gjelbera, objekti disponon nje hapsire per parkimin e automjeteve.

Aktiviteti qe zhvillohet

1. Subjekti blen pjese kembimi dhe i kalon direkt per shitje
2. Subjekti blen kryesisht ne pjesen me te madhe te rasteve gjysmat e makinave dhe ndaj nuk ka vajra dhe bateri kryesisht nga procesi i demontimit. Jane mbetje per te cilat subjekti gjithsesi per cdo rast ka lidhur kontrata qe i dergon tek furnitoret e licencuar per ti marre ato.
3. Subjekti blen nga nje individ me kontrate noteriale nje makine te dal jashte perdorimit per demontimin e plote te saj.

Pra subjekti nuk ka lende te para, nuk ka proces prodhimi. Ai blen pjese kembimi dhe i shet direkt, ose blen gjysma makinash dhe i cmonton brenda kapanonit dhe i shet pjeset e tyre. Duke qene se blen gjysmen e makines eliminon mbetjet qe kane kur makina cmontohet ne teresi. Megjithate jan marre masat nga subjekti qe kapanoni te jete i mbyllur , i sistemuar me rafte dhe teresisht i betonuar te kete kontratat e perkatese per cdo rast te mundshem te krijimit te mbetjeve. Pergjithesisht subjekti shet cdo gje qe cmonton pasi cdo gje ka vlere ne treg qe ai nxjerr nga makina. Edhe pjeset e vogla qe ngelin shiten ne grup tek serviset e medha.

Pajisjet qe disponohen per kryerjen e aktivitetit:

- Vegla te ndryshme (trapano bangoje, gurzmerilo bangoje, impiante par karikimin e baterive)
- Pajisje per heqjen e vajit me vakum
- Krik makine, Krik Kamjoje
- Kompresor, Mates ajri
- Impianti i fumizimit me energji elektrike
- Pajisje par cmontimin e gomave
- Vinc per motoret e makinave
- Impianti i fumizimit me ajer
- Fucia e depozitimit te lubrifikanteve
- Prese mekanike
- Krik per motorin e automjeteve
- Rafte par vendosjen e motoreve te automjeteve
- Pajisjen e gazit dhe metanit e vendosur ne sektorin e trajtimit te automjeteve te dale jashte perdorimit. Kjo pajisje sherben per nxjerrjen e gazeve nga serbatolet e gazit te automjetit qe trajtohet.
- Rekuperatori multigaz per gaz refregjerant.

- Prese hidraulike per zvogelimin e vellimit te gabines se automjetit.
- Ngarkues me kapje mekanike ose magnet.
- Makineri e coptimit
- Autovinxhi pirun
- Pajisje te ndryshme mekanike, elektrike etj. qe perdoren nga punonjesit
- Makina larese
- Karro ngritese e transportuese
- Kazane metalike, plastike etj qe sherbejne per mbajtjen dhe transportin e mbetjeve te lengeta apo te ngurta qe dalin gjate demontimit te automjetit.

Makineritë dhe pajisjet janë të thjeshta të gjitha me drejtim automatik, të pajisura me çertifikatën CE sipas standartit të prodhuar dhe të thjeshta e të sigurta në përdorim.

- Pershkrim i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi

Ne Evrope vendi jone radhitet ne vendet me llojshmeri bimore me te madhe, qe lidhet me ndryshimin e klimes, te tokave, te relievit etj. Ne rajonet perendimore dhe bregdetare mbizotrojne llojet mesdhetare te bimesise si: mareja, shqopa, ilqja, etj., kurse ne brendesi te tyre, bimet e Evropes Lindore dhe Qendrore si: dushku, ahu, bredhi, pisha e zeze etj. Gjithashtu jane te shumta bimet endemike, pra bimet qe riten vetem ne vendin tone. Per shkak te mbizotrimit te relievit kryesisht kodrinoro-malor, qe kushtezon ndryshime te dukshme te klimes dhe te faktoreve te tjere, bimesia eshte e shkallezuar ne drejtimin vertikal ne kater breza: brezi i shkurreve dhe i pyjeve mesdhetare, brezi i dushqeve, brezi i ahishteve dhe i haloreve dhe brezi i kullotave alpine.

Bimesia qe rritet perreth objektit ku do te zhvillohet aktiviteti eshte kryesisht shkurre si dhe bime te kultivuara ne ara.





- **Informacion per pranine e burimeve ujore ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij**

Ne afersi te objektit nuk ka burime ujore. I vetmi lum qe kalon ne zone eshte lumi Drin, i cili ndodhet ne nje distance prej 652 m ne vije ajrore nga objekti ku zhvillohet aktiviteti.



Lumi Drin është lumi më i gjatë jo vetëm i vendit tonë, por edhe i Ballkanit perëndimor. Nga pikëpamja fiziko-geografike, sipërfaqja e përgjithshme e pellgut ujëmbledhës është 14173 km² ndërsa gjatësia 285 km. Ky lumë formohet nga bashkimi i Drinit të Zi, i cili buron nga Liqeni i Ohrit, në një kuotë 694 m, duke përshkuar një rrugë 40 km jashtë territorit të vendit tonë. Nga ana tjetër, Drini i Bardhë buron në malësinë e Zhbelit, në trajtën e një burimi karstik, dhe pasi merr me vete edhe disa lumenj te rangut më të ulët si Toplugen, Bisticën e Prizrenit, Erenikun etj derdhet në liqenin e Fierzës, duke përshkuar një rrugë me gjatësi rreth 136 km. Prurjet mesatare vjetore të Drinit të Zi janë rreth 116 m³/sek, të Drinit të Bardhë 66,4 m³/sek, ndërsa Drini i Bashkuar në derdhje rreth 350 m³/sek. Ushqimin kryesor e përbëjnë rreshjet e shiut dhe të dëborës si edhe burimet përreth. Nga disa llogaritje të përafërta ka rezultuar se ushqimi nga ujrat nëntkësorë (burimet) zë rreth 30-35% të prurjeve mesatare vjetore. Në varësi të shpërndarjes brenda vitit së prurjeve të rrjetit hidrografik të Drinit, vihen re dy faza :

- 1.Faza e prurjeve maksimale në muajt Nëntor-Maj me 75-80% të sasisë së përgjithshme
- 2.Faza e prurjeve minimale në muajt Korrik-Shtator me 20-25% të prurjeve.

Vëllimi mesatar i prurjeve të ngurta është 15.410.000 ton/vit që i përgjigjet një moduli 1160 ton/km² në vit, një prurje mesatare 416 kg/sek dhe turbullirë 1280 gr/m³.

Nga Vau i Dejës derisa derdhet në Bunë, shtrati i tij zgjerohet deri në 2-3 km në një reliev tërësisht fushor.Zona në të cilën shtrihet lugina e lumit Drini i Zi karakterizohet nga një klimë kontinentale përsa I përket temperatures dhe reshjeve, me verë të thatë dhe mesatarisht të nxehtë e dimër të frohtë. Reshjet e dëborës fillojnë në muajin Nëntor dhe shkrihen në muajin Mars.Temperatura mesatare vjetore është rreth 11°C. Temperatura maksimale e matur në stacionin meteorologjik të Peshkopisë është 38.8 °C , ndërsa temperature minimale është -20.8 °C, e matur ne muajin më të ftohtë në Janar.Si temperature minimale edhe ajo maksimale e kanë probabilitetin e ngjarjes një here në 20 vjet. Sasia reshjeve vjetore sipas stacionit meteorologjik të Peshkopisë , është 990 mm/vit. Pjesa më e madhe e reshjeve bie në muajt Nëntor-Dhjetor. Një pjesë e mire e reshjeve bie në formën e dëborës ku trashësia mesatare arrin 15-20 cm. Trashësia maksimale arrin deri në 100 cm. Numri i ditëve me shtresë dëbore është 30-35, të përqendruara kryesisht në muajt Janar dhe Shkurt. Në rrjedhën e poshtme Drini ka klimë të larmishme, kryesisht një klimë mesdhetare deri në kontinentale me dimër të butë e reshje të bollshme, me verë të nxehtë dhe të thatë. Rreshjet janë kryesisht nga shiu dhe më pak dëborë. Sasia mesatare e tyre arrin deri në 2200 mm në vit. Ndërsa temperatura më e lartë arrin afro 40 °C në muajin Korrik, temperaturat nën zero numërohen nga 20 deri 30 ditë në vit, gjatë dimrit.



- Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme negative ne mjedis te projektit perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer

Ndikimet ne biodiversitet

Problemet e biodiversitetit perbejne aktualisht nder problemet më me rendesi ne rruzullin tokesor. Termi biodiversitet eshte shume kompleks dhe si i tille, zhvillimi dhe percaktimi i strategjive te pershtatshme per mbrojtjen e tij, shoqerohet me nje proces te veshtire zgjedhjesh dhe vendimmarrjesh. Biodiversiteti perben teresine e llojeve dhe ekosistemeve ne nje rajon, apo ne gjithe rruzullin tokesor. Ekosistemet jane te nje rendesie te vecante sepse ato perbejn bazat per ekzistencen e llojeve. Cenimi i tyre, si rezultat i aktiviteve te ndryshme ekonomike

shoqerore perben nje shqetesim per njerezit dhe studiuesit . Vlera e nje biodiversiteti te larte per njerezimin jepet para se gjithash nepermjet funksionit te tij si stabilizator i biosferes dhe si burim direkt i prodhimit.

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk do te cenohet biodiversiteti i zones, zona nuk përfaqëson zone me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për “Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundëshme” për tu shpallur “Peizazh i mbrojtur”.

Ndikimet ne toke, uje, ajer

Zhvillimi i aktivitetit te demontimit te automjeteve jashte perdorimit nuk ka ndikime negative ne toke. Te gjitha vajrat qe dalin depozitohen ne fuci plastike derisa terhiqen nga subjekt i licensuar per trajtimin e metejshem te tyre. Aktiviteti nuk perdor ujin ne procese teknologjike, pra nuk ka ndikim ne uje. Uje sigurohet nga rrjeti dhe perdoret vetem per nevoja higjeno sanitare.

Nga aktiviteti i demontimit te automjeteve nuk ka ndikime ne ajer.

Gjatë goditjeve për futjen dhe nxjerrjen e detaleve të çiftëzuara, gjatë zberthimit të gomave me pajisje dore pneumatike apo elektrike si dhe gjatë fryrjes së gomave me ajër nga kompresori i instaluar në krijohen zhurma të niveleve të ndryshme, të cilat janë për një kohë të shkurtër dhe të padëmshme për mjedisin rrethues dhe shëndetin e punonjësve.

Ndërrimi i vajit nga automjetet do të bëhet duke thithur me pajisje me vakum, duke mos lënë asnjë mundësi që vaji të derdhet në mjedis.

Ndikimet e identifikuar nga zhvillimi i aktivitetit jane ndikime direkte ne mjedis.

Tabela e identifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne toke.

	Ndikimi i mundshem	Sqarim
1	Derdhja pa dashje e vajrave dhe lubrifikanteve nga mjetet e punes.	Behet fjale per ndonje rast te rralle te rrjedhjes gjate difekteve dhe çarje te tubave dhe sotokartit te mjeteve motorike si dh egjate demontimit te tyre.

Tabela e identifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne ajer.

	Ndikimi i mundeshem	Sqarim
1	Shkarkimi i gazeve ne sasi minimale nga lenda djegese	Sasia e gazeve nga djegia e karburantit qe do te shkarkohet nga mjetet motorrike. Eshte standart i teknologjise se prodhimit te mjeteve dhe i karburantit.
2	Emetimi i zhurmave nga proceset e punes se demontimit	Vlerat standart te emetimit te zhurmave sipas teknologjise se prodhimit te makinerive, kontroll teknik te makinerive te shoqerise.

- **Nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis te tilla si ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime si dhe per prodhimin e mbetjeve**

Uji do perdoret vetem per nevojat e perditshme higjeno sanitare dhe pastrim te ambjentit.

Në procesin e punimeve mbërthim-zbërthim, krijohen zhurma të lehta të padëmshme për punonjësit dhe mund të ndodhi që të ngrihet ndonjë ashkël metal nga ky proces. Për këtë arsye personeli përkatës do të jetë i mbrojtur me anë të maskave special ndaj pluhurave dhe me syze transparente për mbrojtjen e syve. Në trapano krijohen ashkla metalike që shpërndahen mbi bangon e saj. Gjithashtu do të shpërndahet edhe ujë që përdoret për ftohjen e puntos së shpimit. Uji është pa përmbajtje të dëmshme të veçanta dhe shkarkohet në sistemin e kanalizimit të brendshëm (rrjeti i drenazhimit të ujrave – vaskë dekantimi) dhe nëpërmjet saj në kolektorin kryesorë të zonës– rrjetin e kanalizimeve. Ujerrat e shiut do te sistemohen permes kanaleve perimetrike dhe me pas do i bashkohen kanalizimeve te zones. Theksojme se ujerat nuk permbajn elemente kimike ndotes.

- **Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuar**

Gjate fazes normale te operimit te projektit nuk do te kete emetime te gazeve, lengjeve, mbetjeve toksike, helme te ndryshme dhe substanca te tjera te demshme, te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin perreth, floren dhe faunen e zones, burimet ujore. Meqenese nuk do te perdoren ne procesin e demontimit lende te demshme, nuk do te kete shkarkime te lendeve kimike te demshme per mjedisin ne ajer, toke dhe uje. Objekti ku do te zhvillohet aktiviteti eshte ekzistues. Ushtrimi i aktivitetit ne kete siperfaqe nuk ndikon negativisht ne cilesine dhe sasine e tokes bujqesore. Tokat bujqesore ndodhen jasht zones ku do te kryhet aktiviteti.

Persa i perket ndikimit ne peizazhin ekzistues dhe topografine ky aktivitet nuk ka ndikim negativ. Ne afersi te tij zhvillohen edhe aktivitete te tjera industriale.

- **Te dhena per shtrirjen e mundshme hapesinore te ndikimit negativ ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te**

Duke njohur procesin e demontimit te automjeteve jashte perdorimit u indetifikuan ndikimet e mundeshme negative ne çdo receptore - perberes te mjedisit ne objekt.

Identifikimi i ndikimeve – Permes te cilit u percaktua nderveprimi mjedis-projekt i demontimit dhe u indetifikuan ndikimet e mundshme gjate kesaj faze sipas receptoreve te mjedisit.

Vleresimi i ndikimeve – Ekspertet mjedisore te fushave te ndryshme bene perpjekje per matjen e gravitetit te ndikimeve . Vleresimi i Sinjifikances ka te beje me vete rendesine e ndikimeve dhe

është faza më e rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe përafrohet me objektivisht me teresinë e bashkeveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e përdorur për vlerësimin e rëndësise së ndikimeve variojnë dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit të ndikuar.

Shtrirja fizike- Vlerëson sipërfaqen apo dimensionin hapësiror të një ndikimi të dhënë në raport me burimin që gjeneron atë ndikim.

- **Kohezgjatja e ndikimit** – Vlerëson se sa do të zgjase një ndikim i caktuar në dimensionin kohë (ndikim i përhershëm apo i përkohshëm). Në rastin tone zhvillimi i aktivitetit nga shoqëria është për një afat të pacaktuar. Ndërsa të gjitha ndikimet e tjera negative në mjedis janë të përkohshme, si shkarkimet e ujërave të reshjeve, emetimet e pluhurave gjatë lëvizjes së automjeteve, etj

-**Kthyeshmëria** –Vlerëson mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar në gjendjen e tij të mëparshme (aftësia për tu rehabilituar dhe regjeneruar)

-**Rëndësia** – Realizon një vlerësim total të tre përmasave të mësipërme dhe njekohësisht thekson vëmendjen që duhet patur për administrimin e ndikimit.

Ndikimet e parashikuara nuk kanë shtrirje të mëdha fizike, objekti ku zhvillohet aktiviteti ndodhet në largësi nga zona më e afërta e banuar dhe nuk preket nga zhvillimi i këtij aktiviteti. Zhurmat që krijohen gjatë lëvizjes së automjeteve nuk përbejnë ndotje akustike. Analiza e frekuencës të zhurmës të emetuar nga këto mjete tregon se ato ndodhen në mesataren e frekuencës 100 – 150 Hz , e cila është e pranueshme nga veshi i njeriut . Koha në të cilën do të jenë të pranishme këto zhurma është vetëm gjatë ditës, meqenëse në objekt do punohet vetëm në një turn. Niveli i zhurmave të këtyre mjeteve në largësi nuk do të jetë i madh dhe do të jetë konform normave në fuqi.

- **Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin**

Për shkak se objekti është ekzistues nuk ka program ndërtimi. Koha e funksionimit të objektit nuk është parashikuar nga administratori, I cili do të zhvillojë këto aktivitete për një afat të pacaktuar.

Synimet e Planit të Rehabilitimit Plani i rehabilitimit synon që:

- Të ketë realizuar stabilizimin fizik të objektit ku ndodhet instalimi.
- Të ketë realizuar punimet biologjike me qëllim mbrojtjen e mjedisit të zonës dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.
- Të ketë pastruar të gjithë sipërfaqen në shfrytëzim nga makineritë, instalimi dhe mbetjet e ndryshme, si dhe rikthimin e saj në gjendjen e mëparshme
- Të ketë mundësuar zhvillimin e proceseve natyrore të cilat dallohen qartë nëpërmjet indikatorëve abiotike dhe biologjike dhe evolutive me studimin e zhvillimit të riaftësisë .

Mirëmbajtja e bimësisë

Me qëllim përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe mbrojtjen e mjedisit nga ndotja, subjekti kujdeset për mbarëvajtjen e bimësisë rreth objektit. Synimi i saj është shtimi i hapësirave të gjelbërta në territorin ku zhvillon aktivitetin e saj, rrethimi i objektit me kurorë pemësh autoktone duke harmonizuar objektin me vlerat biologjike të zones. Masat rehabilituese të planifikuara

- Punime inxhinjerie
- Punime biologjike
- Punime inxhinjerie
- Mirëmbajtja e rrugëve automobilistike
- Mirëmbajtja e kanaleve për drenazhim dhe disiplinimin e ujrave (reshjet atmosferike)
- Punime biologjike
- Mbjellja e bimësisë.

PLANI DHE MASAT PËR REHABILITIMIN E MJEDISIT

Për rehabilitimin e mjedisit të shfrytëzuar, rehabilitimi do të fillojë nëse aktiviteti i subjektit “ROBI- IMPORT- SERVIS” do të mbyllet apo do të transferohet diku tjetër, subjekti me të detajuar koston e rehabilitimit do ta trajtojë bazuar në masa për rehabilitimin e mjedisit si më poshtë:

- Krijimin e sipërfaqeve për mbjellje
- Sistemin strukturës ku ndodhet instalimi.
- Pastrimin e zonës nga çfarëdo lloj mbetje të gjeneruar nga çmontimi i impiantit
- Mirëmbajtjen e sipërfaqeve të mbjella.

- **Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis**

Identifikimi i masave për të eliminuar apo zbutur ndikimet negative në mjedis

- Planifikimi i zones së instalimit

Për shmangien dhe parandalimin e gjenerimit të pluhurave dhe zhurmave, si dhe për ruajtjen e regjimit të linjës së Magazinimit i hekurishteve ose skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme dhe demontim i mjeteve jashtë përdorimit, në projekt është përcaktuar funksionimi harmonik dhe i kombinuar në kohë dhe hapësirë i objektit në tërësi dhe i linjës së Magazinimit i hekurishteve ose skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme, demontim i mjeteve jashtë përdorimit.

Në objektin ku ndodhet instalimi është parashikuar hap pas hapi, rigjenerimi i mjedisit të brendshëm e të jashtëm, sistemimi i lëndës së parë, parkimi i mjeteve, magazinimi i pajisjeve/makinerve ndihmese dhe ngarkimi i pjeseve, duke realizuar shfrytëzimin sa më eficient të mjedisit të shfrytëzuar nga subjekti.

Pergjate perimetrit te zones ku eshte ndertuar objekti eshte mbjelle kurore pemesh te gjelberta me

distance na njera tjetra prej 2 m. Kjo sipërfaqe e përfutur nga trajtimet e mësipërme, do të japë mundësi për rikultivimin e bimëve dhe pemëve të ndryshme, duke krijuar njëherësh kushte për

parandalimin e emetimit të grimcave të pluhurit, kapjen e ndotesve atmosferik dhe përmiresimin e pamjes së përgjithshme të mjedisit të zonës në shfrytëzim.

Duhet theksuar se sipërfaqja e objektit në shfrytëzim nga shoqëria nuk përbën ndonjë ndikim negativ në zone.

Per me teper rekomandimet per te parandaluar dhe kontrolluar rrezikun e ndotjes perfshijme:

- Mbetjet urbane te paperdorshme te grumbullohen transportohen dhe depozitohen ne oraret e caktuara nga Njesia Vendore.
- Te realizohet ndricimi perreth(vendosja e impiantit te ndricimit).
- Te kryhet rregullimi i territorit ne perputhje me kondicionet urbane te percaktuara.
- Shoqëria te operoje ne perputhje te plote me normat qe jane ne fuqi, dhe te kryej monitorime te vazhdueshme te tregueseve mjedisor te trysnise ne mjedis.
- Te respektoje te gjitha rregullat e mbrojtjes kundra zjarrit gjate operimit ne ndertese dhe te

respektoje rregulloren e MKZ.

- Mbetjet qe gjenerohen te grumbullohen, transportohen dhe asgjesohen nga subjekte te licencuara.
- Te instalohen dhe te respektohen sinjalistikat e trafikut te cilat do te minimizonin impakti per aksidente te mundshme.
- Per te minimizuar impaktin ndaj zhurmave dhe vibrimeve, te limitohen proceset e zhurmshme gjate oreve me te ndjeshme, ndermjet ores 20 deri ne 07 te mengjesit.
- Te respektoje te gjitha kushtet dhe masat qe do te vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.
- Alternativën në lidhje me zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur;
- Vendosja e ketij instalimi ne kete zone eshte e pershtatshme per zhvillimin e ketij aktiviteti pasi eshte ne distance te konsiderueshme nga zonat e banuara, objektet apo veprat hidroenergjetike, etj.

MASAT E PROPOZUARA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SECILI NDIKIM NEGATIV

<i>Rekomandime për zbutjen e ndikimeve</i>	
Toka	
Përdorimi i Tokës	Kryerja e aktivitetit brënda siperfaqes se miratuar.Respektimi i kushteve teknike dhe standarteve.
Erozioni	
Mbrojtja nga erozioni	Zbatimi rigoroz i masave teknike për zhvillimin e aktivitetit. Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave te pastrimit. Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës. Mirembajtja e bazamentit ku jane te

	instaluara pajisjet qe ndihmojn ne zhvillimin e aktivitetit te demontimit te mjeveteve jashte perdorimit.
--	---

Biodiversiteti	
Vegjetacioni Dëmtim potencial I vegjetacionit	Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidaneve të rinj, përgjatë rrugës që ben të mundur hyrjen për në objekt.
Cilësia e ajrit	
Rritje e emetimeve në ajër nga proceset	Pastrimi periodik I pajisjeve që shërbejnë për zhvillimin e aktivitetit, duke mbarëvajtur operimin optimal të tij. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse për frymarrjen, maska me karbon. Mjete me kolaudim optimal. Pjesë kembimi rezerve brenda objektit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim I karburanti cilësor. Pastrim periodik i objektit duke mbarëvajtur operimin optimal të tij.
Sistemi i drenazhimit	
Sistemi i drenazhimit	Mirëmbajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave të pastrimit përgjatë gjithë gjatësisë së objektit, bashkimi i tyre në rrjetin e kanalizimeve.
Mbetjet	
Shtim i mbetjeve urbane nga aktiviteti dhe punonjësit që do të operojnë në objekt.	Vendosja e kontenerëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në venddepozitim më të afërt të caktuar nga njësia vendore.
Zhurmat	

<p>Rritje e nivelit të zhurmave nga impianti/ instalimet dhe nga lëvizja e mjeteve</p>	<p>Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Përdorim i instalimeve brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit). Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjate orareve të përshtatshme.</p>
<p>Trafiku rrugor</p>	
<p>Trafiku Rrugor Rritje e fluksit të qarkullimit te mjeteve</p>	<p>Lëvizshmeria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut. Mjetet e transportit do te levizin brenda normave te lejuara te shpejtesise, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.</p>

Ndjekja e gjithë kërkesave ligjore për venien në funksion të aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve të treta.

- Aktiviteti kryesisht do të zhvillohet në ambient të mbyllur kështu që nuk do ketë nivele zhurmash domethënëse për zonën përreth. Do të bëhet pajisja e punonjësve me mjete mbrojtëse personale.

-Nga ky aktivitet nuk parashikohen të ketë ndikime në ndryshimin e habitateve
- Do të ndiqen gjithë rregullat e sigurimit teknik në punë si dhe pajisjes së punonjësve me uniformat dhe mjetet e nevojshme të mbrojtjes në punë.

- Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi.

Plani i monitorimit

Plani i monitorimit do të konsistojë në :

-Monitorimi i zonës së mundëshme të gjenerimit të pluhurave gjatë aktivitetit të Magazinim i hekurishteve ose skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme, demontim I mjeteve motorike jashtë përdorimit

- Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike të shpërndarjes së emetimeve të pluhurave dhe marrja e masave përkatëse të parashikuara në projekt, për parandalimin e tij.

-Monitorimi i sjelljes së bimësisë ekzistuese në zonën përreth objektit dhe marrja e masave për parandalimin e dëmtimit të tyre.

- Monitorimi I sipërfaqeve të mbjella, pemëve dhe bimëve të kultivuara, ecurisë normale e mbirjes dhe zhvillimit të tyre. Në rastet kur vërehet se ka dëmtime merren masa për zëvendësime dhe fidanë të rinj. Monitorimi I çdo sipërfaqe të mbjellë do të vazhdojë për një periudhë 4 vjecare, kohë gjatë së cilës bimët kanë një zhvillim të konsiderueshëm dhe nuk kanë më nevojë për shërbime specifike.

- **Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille)**

Aktiviteti zhvillohet ne Fshatin Gocaj , Njesia Administrative Balldren, Lezhe dhe nuk ka ndikime ne mjedisin nderkufitar.